



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: 20.2.2023

Nr: 7

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E LLOJIT TË TË DHËNAVE QË TRANSMETOHEN NGA PAJISJA ELEKTRONIKE E IDENTIFIKIMIT DREJT INFRASTRUKTURËS SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TIK) TË KQZ DHE RREGULLAT PËR MËNYRËN E TRANSMETIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronja “e” dhe të nenit 22, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Të dhënat që transmetohen gjatë ditës së zgjedhjeve nga pajisja elektronike e identifikimit (PEI) drejt infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të KQZ përfshijnë:
 - a) Numrin e pajisjeve të konfiguruar,
 - b) Numrin e PEI ku procesi i identifikimit është hapur,
 - c) Numrin e PEI ku procesi i identifikimit është mbyllur,
 - ç) Numrin e votuesve që janë identifikuar,
 - d) Numrin e votuesve sipas gjinisë (femra/meshkuj),
 - dh) Numrin e votuesve për herë të parë (18+ vjeç),
 - e) Numrin e votuesve sipas grupmoshës (18-24, 25-34, 35-44, 45-54, 55-64, 65+),
 - ë) Numrin e votuesve të identifikuar me shenja gishtërinjsh,
 - f) Numrin e votuesve të identifikuar pa shenja gishtërinjsh,
 - g) Numrin e votuesve të veçantë,
 - gj) Numrin e votuesve me vendim gjyqate,
 - h) Numrin e votuesve të verifikuar në qendrën e votimit të gabuar (zgjedhës të cilit dokumenti i identifikimit i është skanuar nga PEI dhe nga skanimi rezulton se ai votues

Data: 20.2.2023 Nr: 7
Ora: 14:00



“Për miratimin e llojit të të dhënave që transmetohen nga pajisja elektronike e identifikimit drejt infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të KQZ dhe rregullat për mënyrën e transmetimit të tyre”

duhet të paraqitet në një tjetër qendër votimi),
i) Numrin e tentativave të dyfishta të identifikimit.

2. Të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, do të transmetohen nëpërmjet një modemi USB, me kartë SIM, i cili vendoset në një nga portat USB të PEI.
3. Modemi USB konfigurohet në mjediset e KQZ-së vetëm nga stafi i këtij të fundit gjatë procesit të përgatitjes së PEI.
4. Kapaku i folesë ku vendoset modemi duhet të vuloset fizikisht me kode sigurie nga stafi i KQZ-së. Numrat serial të kodeve të sigurisë mbahen shënim në procesverbal në momentin e dërgimit të PEI dhe kontrollohen në kthim nga stafi i KQZ-së për të vërtetuar paprekshmërinë.
5. Siguria e informacionit zbatohet nëpërmjet certifikatave dhe çelësave të enkriptuar.
6. Transmetimi i të dhënave ndodh me frekuencë periodike.
7. Informacioni që do të transmetohet nga PEI drejt TIK të KQZ aksesohet vetëm nga stafi i KQZ.
8. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

Data: 20.2.2023 Nr: 7
Ora: 14:00



“Për miratimin e llojit të të dhënave që transmetohen nga pajisja elektronike e identifikimit drejt infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të KQZ dhe rregullat për mënyrën e transmetimit të tyre”